



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROCESVERBAL**

**Nr. 9, datë 28.10.2024**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit  
Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:10

Data e mbajtjes së mbledhjes : 28.10.2024

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës:** Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako, si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi:** Përshëndetje të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar të pranishëm!

Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës së këshillit bashkiak.

Siç jeni vënë në dijeni për rendin e ditës nga Sekretaria e Këshillit nëpërmjet postës elektronike, në këtë mbledhje do të marrim në shqyrtim projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë dhe kryetari i këshillit.

Ftoj sekretaren të procedoj me thirrjen e emrave të këshilltarëve për prezencën.

**Dorina Milja:** Fillojmë.

Ardian Muka .....deri tek.... Florian Tahiri.....

42 Këshilltarë në sallë .

**V.O...** *Hyn me vonesë gjatë mbledhjes këshilltarja Joniada Musaraj,.Gjithsej gjatë mbledhjes 33 këshilltarë në sallë pasi disa këshilltarë të opozitës u larguan nga mbledhja.*

**Ani Dyrmishi:** Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.

Sot në rend dite kemi 14 pika, pasi njëra është tërhequr.

Pika 1. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHTATOR 2024.
Pika 2. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DETAJIMIT TË FONDEVE TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT PER EFEKT TE RRITJES SE PAGAVE.
Pika 3. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË APARATIT TË BASHKISË SË DURRËSIT.
Pika 4. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË DURRËSIT.
Pika 5. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË BASHKISË DURRËS
Pika 6. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË BASHKIAKE, DURRËS.
Pika 7. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 195, DATË 22.12.2023, “MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMEËM 2024-2026 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2024”
Pika 8. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6 064 000 LEKË, TË ALOKUARA NGA BASHKIA DURRËS NË ZBATIM TË VKB-SË NR.90, DATË 24.09.2024 “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT MIDIS ASHK-SË DHE BASHKISË DURRËS PËR PËRFUNDIMIN E PROCESVE KALIMTARE TË PRONËSISË DHE TË TRAJTIMIT ME PRIORITET TË

	PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE TË PAPËRFUNDUARA PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE NË ZONAT ME PRIORITET ZHVILLIMI URBAN DHE ZONAT INFORMALE TË BANIMIT NË BASHKINË DURRËS”
Pika 9. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	<u>Është tërhequr nga bashkia.</u>
Pika 10. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË PIKËN 1, TË VKB SË NR.575, DATË 20.12.2018 TË NDRYSHUAR, PËR SA I PËRKET VENDNDODHJEVE TË REJA TË VENDQËNDRIMEVE TAKSI (4+1) DHE (8+1) NË QYTETIN E DURRËSIT.
Pika 11. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.73, DATË 29.07.2024 PËRSA I PËRKET ZNJ.EDLIRA ÇOPA.
Pika 12. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN TETOR 2024.
Pika 13. Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS DHE FORMULËS SË SHPËRNDARJES SË SUBVENCIONIMIT PËR OPERATORËT E SHËRBIMIT TË TRANSPORTIT PUBLIK QYTETAS NË QYTETIN E DURRËSIT.
Pika 14 Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit propozuar nga Kr. i Këshillit	PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR.123, DATË 13.07.2023 “PËR MIRATIMIN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHËM TË KËSHILLIT BASHKIAK DHE PËRBËRJEN E TYRE”.
Pika 15 Rishqyrtim dhe rimiratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2025-2027 TË BASHKISË DURRËS
*****	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

Atëherë përse i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment?

**Dritan Burgija** : O zoti Kryetar !

Përpara se të kalojmë në votim të rendit të ditës do doja të mbaja disa qëndrime, përpara se të votojmë, sepse mbi bazë të kësaj do mbajmë disa qëndrime si opozitë.

Po flas në emër të grupit, por ndoshta edhe më gjerë dhe të opozitës. Jemi mbledh sot dhe pikat kryesore që janë për tu diskutuar janë rritjet e pagave të aparatit të bashkisë. Nuk mund të lë këtu pa përmend dhe pa reaguari që ndërkohë që ndihma ekonomike është minimum 22 mijë lekë të vjetra, rritet paga e kryetares së bashkisë me 57 %, e përkthyer kjo në një milion e pesëdhjetë mijë lekë, minimumi i nënpunësve të bashkisë rritet me 7 %. Jemi, keni rritur, s'kemi asnjë rol në këto pjesë, pensionin me 4.1 %, një tallje me pensionistët. Nëse do të ishte vetëm rritja juaj e pagës 4.1 % do ta kishim votuar me qefin më të madh sot rritjen e pagave, sepse e theksoj, nuk jemi kundër rritjes së pagave. E kemi thënë dhe herë tjetër këtu, që rritja e pagava përkthehet në shërbim më të mirë për qytetarët, por 4.1% pensionistëve dhe 57 % rritja e pagava të aparatit tuaj kjo nuk shkon. Diskriminim të tillë nuk mund pranojmë.

Pastaj përse i përket pikës tjetër që mund të hasi debat është subvecioni për transportin publik, jeni komplet në mungesë transparence përse i përket kësaj pike. Minimumi të na vendosnit relacionin në dispozicion, kërkonim më shumë se kaq, por të paktën relacionin, mund të kërkonim dhe kontratat që keni të lidhur mungesë transparence me të gjithë operatorët.

Kështu që, pastaj si mund të rrimë të merremi sot me pagat e aparatit të bashkisë me rrogat tuaja, ndërkohë që e dini shumë mirë që në këto momente po hyn anija me 2100 ton mbetje toksike.

Të nderuar koleg socialist dhe të gjithë partive të tjera, Partia Demokratike dje protestoi përpara hyrjes së portit për hyrjen e 2100 ton mbetjeve, helmeve, por këto helme nuk vijnë vetëm për Partinë Demokratike, vijnë edhe për ju edhe për fëmijët tuaj, se kemi vendosur që do t'i rrisim këtu. Kështu që, do të ishte shumë mirë që në atë protest tu bënim një herë të gjithë bashkë. Edi Rama, ndërkohë që i kërkon votën durrsakëve, se ka filluar duke i kërkuar votën durrsakëve, po i mbush me helme. Durrsakët e mbajnë mend shumë mirë, brezi im dhe brezi më i madh se unë se çfarë ndodhi në kohën e Ramiz Alisë, të asaj diktature, dua ta lidh pak me diktaturën e sotme. Ndodhi që gjithë gropa e Nishtullës u mbush me duhanin e Cernobilit dhe atje banojnë sot mijëra familje. Përtej asaj filluan atë duhan ta prodhojnë nga halli për të mbushur arkën, për të mbushur xhepat e vet, filluan ta prodhojnë duhanin "Partizani", që e tymosën baballarët tonë dhe baballarët tuaj, si socialist dhe ato të deglasumit në atë kohë. Vijnë më pas, qeveria e Ylli Bufit në 91-shin e mbushi Shqipërinë përpara se të ikte ndërkohë që i fuste në panik shqipëtarët që kemi dhe 6 ditë bukë, e mbushi Shqipërinë me pesticide të skaduara nga Gjermania Lindore, dhe pasojat dhe faturat i paguajnë qytetarët shqiptarë. Mesa duket diktaturat në ikje këtë bëjnë, helmojnë qytetarët e vet përpara se të ikin.

Unë do ti bëja thirrje sot, ndërkohë që anija me mbetje po hyn në nuk mund të rrijmë të tallemi me qytetarët, të rrisim rrogat e aparatit të bashkisë në diskriminim të plotë me çdo shtresë tjetër me pensionistët, ndërkohë që juve ju digjen njerëzit përpara bashkisë, sepse nuk kanë me çfarë lekësh ta shtyjnë muajin.

Kështu që, do t'i bëja thirrje të gjithë kolegëve, e kam me ato opozitar, që t'i bashkohet kësaj thirrje kushdo nga socialistët, ato që e ndjejnë veten që janë të ndershëm, ta braktisim këtë sallë sot, sepse nuk mund të tallemi me qytetarët në këtë formë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Ju faleminderit .

**Munir Konesha**: Duroni, duroni...

**Dritan Burgjia**: Vazhdoni vet se nuk mund të bëhem dot pjesë e kësaj farse.

**Llesh Çuni** : Po ju thatë që, po qe se ndonjë është i ndershëm të vi me ju.

**Dritan Burgjia**: Hajde je i mirëpritur, i mirëpritur!

**Llesh Çuni**: Ça frike, mo?

**Ani Dyrmishi**: Tha i mirëpritur.

**Llesh Çuni** : Aaaa...

**Flutura Kasa** : Hajt rruga mbarë, rruga mbarë se shyqyr që nuk i shkulni dot karriget. Por desha me thënë këtë. Ndërkohë që deputetët marrin mbi 3 milion, më fal për shprehjen "që dredhin leshtë", i takon kryetares së bashkisë dhe aparatit të bashkisë rritja rrogave se është bashkia e dytë në Republikë, prandaj ato pretendime që nxorri Tani më duken kot, sepse për tu largu, kështu që më mirë se jena më rehat.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit

Koment tjetër?

Koment tjetër në lidhje me rendin e ditës ka?

Jo. Atëherë kalojmë në votim.

Kush është pro miratimit të rendit të ditës?

Hapim votimin me elektronik.

E kena për herë të parë.

Të vi pak djali i IT-s.

.... *biseda me njëri tjetrin pa mikrofon.....*

Atëherë mbyllet votimi elektronik

Atëhere, me 33 vota pro, miratohet pika 1.

Kalojmë në pikën 2, më fal kalojmë në pikën 1 se ky ishte rendi ditës.

- Për **pikën 1**, I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale z. Tahiri. Se iku kryetarja e keni ju fjalën. Shtyp mikrofonin.

**Florian Tahiri:** Atëherë përsa i përket pikës 1 “PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHTATOR 2024” Komisioni u mbledh ditën e premte në orën 1 dhe ishin 4 anëtarë, të cilët votuan si gjithmonë unanimitisht pro, përsa i përket pikës 1 të rendit të ditës, ndihmës ekonomike.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit z.Tahiri.

Komente përsa i përket pikës 1, kemi?

Nuk ka.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllim votimin.

Atëhere, me 32 vota pro, 1 abstenim miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 2**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Komisioni i Buxhetit u mbledh për të shqyrtuar pikat që kishim si komision vetëm më pjesëmarrjen e anëtarëve të Partisë Socialiste.

Duke patur parasysh fjalimin amalgam të zotit Burgija, pa i hequr të drejtën që të ketë qëndrim për çdo çështje që ai mendon, që është në interes të forcës së tij politike, mënyra e trajtimit të problemit ishte një katrohurë e vërtetë, me historira, me kujtime, me gjëra, të cilat nuk kishin asnjë lidhje llogjike me njëra-tjetrën. Dhe e theksoj këtë, sepse edhe ky qëndrim që mbajti për ndihmën ekonomike, për pagat e këshillit, e bashkisë, e njësisve, që janë në varësi të bashkisë së Durrësit ishte e domosdoshme pjesëmarrja e tij në komision, edhe për të njohur vendimet përkatëse, arsyet e marrjes së këtyre vendimeve, dhe t’i jepte mbështetjen ose jombështetjen. Ky është qëndrim i çastit që nuk ja vlen prandaj edhe nuk folëm, kurse komisioni të gjashtë anëtarët që morën pjesë në komision votuan unanimitisht për realizimin e këtij projektvendimi të bashkisë dhe kalimin e tij në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Zonja Devolli, Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike.

**Edlira Devolli:** Faleminderit kryetar.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike u mbledh, e shqyrtoi çështjen dhe vendosi që ta kalojë për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëherë komente?

Zoti Myshketa.

**Jonuz Myshketa:** Përshëndetje!

Në lidhje me miratimin e pikës 2 të rendit të ditës siç është miratimi i fondeve të akumuluar nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave në lidhje dhe me pikat e tjerat të miratimit të pagave të punonjësve. Difektet më të mëdhaja të qëndrimi i mëparshëm i kolegëve personalisht gjykoj që

interesat e qytetarëve mbrohen këtu në sallë për të cilin kemi mandatin, gjithsesi janë vendime personale të gjithësecilit, por nuk i hedh poshtë çfarë u thanë dhe është qëndrim kohorent që e kemi pasur që në krye të herës. Si forcë e djathtë, si të djathtë nuk jemi kundër rritjes së pagave të asnjëlloj, qoftë të aparati të bashkisë, qoftë të nënpunësit civil e më gjerë, por më duket pak diskriminues në lidhje me ndihmën që ne japim në vlera jodenjitoze të personave në nevojë 2 mijë lekë ose 3 mijë lekë në muaj dhe pensionet që është një rritje, nuk është një rritje e pensioneve, por është thjesht indeksimi i inflacionit në raport me rritjen e tij.

Do të doja që çdo rritje e pagës të reflektonte në një cilësi shërbimi më të lartë, e cila në shumë raste çalon, dhe në këtë aspekt shpreh vullnetin tim dhe të grupit me qëllim që të abstenojmë duke mos qenë kundër, por e gjukojmë praktikë jo të qenësishme, nuk reflekton ato që janë më emergjente sesa të aparatit të bashkisë e të tjerë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Ndonjë koment tjetër ka?

Nuk ka, kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Votoni të gjithë.

Mbyllim votimin elektronik.

Atëhere, me 30 vota pro, 3 abstenim miratohet pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 3**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Edhe për pikën 3, kalon me votat e 6 pjesëmarrësve të anëtarëve të komisionit.

**Ani Dyrmishi:** Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike, zonja Devolli.

**Edlira Devolli:** Dhe për këtë pikë Komisioni u mbledh, e shqyrtoi çështjen dhe vendosi që ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit .

Koment përse i përket pikës 3?

Nuk ka, kalojmë në votim .

Hapim votimin elektronik.

Mbyllet votimi elektronik.

Atëhere, me 29 vota pro, 4 abstenim miratohet pika 3 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 4**. Zoti Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj:** Edhe për pikën 4 Komisioni votoi unanimitet të kalojë dhe ja kalon këshillit për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Zonja Devolli.

**Edlira Devolli:** Për pikën 4 Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike, vendosi që ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Atëherë hapim votimin elektronik.

**Flutura Kasa:** Kryetar kisha diçka.

**Ani Dyrmishi:** Po, më fal.

**Flutura Kasa:** Meqenëse për kryetarët e njësive, që kanë numrin më të madh të popullsisë paga ishte më e lartë dhe është mëse e drejtë, shof që për specialistët është e njëjtë në të gjitha njësitë administrative. A mund të ishte një përjashtim dhe për specialistët? Sepse nga numër popullsie është edhe për ato, jo vetëm për kryetarët e njësive.

**Emiriana Sako:** Faleminderit Flutura.

Meqenëse janë 6 pika ose 5 pika, që i takojnë rritjes së pagave, secila respektivisht për kategoritë që preknin bashkinë, dua të sqaroj disa gjëra.

Së pari, ky fond është i transferuar 100% nga qeveria shqiptare, pra ne nuk kemi prekur buxhetin e bashkisë për rritjen e pagave dhe bëhet sipas një VKM-je dhe një pune që ka kryer Ministri i Shtetit për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore ku së bashku me bashkitë kanë ngritur problematika të burimeve njerëzore që kanë bashki të caktuara, për afrimin e njerëzve të rinj në strukturat tona duke iu referuar dhe nivelit të pagave. Kjo vjen si pasojë edhe, pra pagat e administratës publike nuk janë të parat që rriten, vjen dhe si një politikë e qeverisë shqiptare për rritjen e pagës minimale në sektorin privat. Kemi parë që pas gati një viti të gjithë i janë përgjigjur këtij detyrimi ligjor, por jo vetëm kaq, por kemi sektor të caktuar, si ai i turizmit kryesisht, që pagat janë, kërkesa për burime njerëzore është rritur shumë si dhe pagat patjetër kanë një qasje për tu përmirësuar. Pra rritja e pagave në administratë vjen si pasojë e këtij vizioni dhe kësaj fryme për rritjen e nivelit ekonomik tërësisht. Ne jemi çdo ditë në kontakt me qytetarët dhe patjetër që kemi interes që të përmirësojmë shërbimet tona në terren dhe nëpërmjet rritjes së pagave vlerësojmë ata që tashmë janë pjesë e institucioneve publike, por edhe kemi mundësi që me rritjen e nivelit të pagës të thërrasim njerëz të aftë dhe të kualifikuar patjetër.

Paga që prek administratën e Bashkisë së Durrësit, dua të ju them disa shifra, janë 628 punonjës të shërbimit, pra pastrimi, gjelbërimi i qytetit, pastrimi i plazheve, të cilët marrin rritje page nga ky vendim i këshillit sot, janë 378 punonjës të shërbimeve të sistemit në klasa në institucionet e varësis si Biblioteka, Qendra Aleksandër Moisiu, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Shkollat 9 vjecare, kopshtet, konviktet, tregu fshatar, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit e të tjera me rradhë. Policia Bashkiake gjithashtu pëson një rritje prej 4000 mijë lekë në muaj. Dhe më tej vazhdojmë me administratat e ndërmarrjeve të institucioneve të varësisë, pra Ndërmarrja Rruga, Ndërmarrja Pastrim Gjelbërim e të tjera me rradhë dhe pjesa e punonjësve të shërbimit civil.



Normalisht narrativa që mos rrisni pagat e administratës, por rrisni pagat e pensionistëve nuk qëndron, sepse sa më shumë, sa më të larta të jenë kontributi i pagave, sigurime shoqërore, aq më shumë kontribut do të kenë mundësi të marrin pensionistët. Dhe në fakt qeveria shqiptare ka nisur një fushatë komunikimi me ta për tu treguar për hapat që janë marrë dhe hapat që do të merren dhe ne parashikojmë mbase në dhjetor apo në fillim të janarit të kemi marrjen e masave konkrete përsa i takon pensioneve, sepse 4.1 % nuk është rritja e pensioneve, e por është indeksimi në bazë të inflacionit.

Pra, kjo është ajo që doja të sqaroja. Pastaj sigurisht që këshilltrët kanë të gjithë atë hapësirën e bërjes politike me instrumente ashtu siç e mendojnë, siç e mendojnë ata, por qëndrimi i institucionit është ky që unë sapo thashë më lartë.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Kryetare.

Koment tjetër? Nuk ka.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi.

Atëhere, me 29 vota pro, 3 abstenim miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 5**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj :** Edhe për pikën 5, komisioni ynë unanimisht e voton dhe e kalon në Këshill Bashkiak për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit z. Xhelilaj.

Komisioni i Rregullores, Çështjeve Juridike znj. Devolli.

**Edlira Devolli :** Komisioni jonë u mbledh, e shqyrtoi dhe vendosi që ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit.

Komente përsa i përket pikës 5 kemi nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka. Kalojmë më votim.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi.

Atëhere, me 30 vota pro, 3 abstenim miratohet pika 5 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 6**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj :** Në vazhdim të ndryshimit të pagave të gjithë sistemit të njëjësive që varen nga bashkia e Durrësit edhe për pikën 6, komisioni ishte unanimisht pro.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit z. Xhelilaj.

Znj. Devolli.

**Edlira Devolli** : Komisioni jonë e shqyrtoi dhe vendosi ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit zonja Devolli.

Atëherë përsa i përket pikës 6 kemi koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka.

Hapim votimin elektronik.

Ju lutem votoni.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 30 vota pro, 3 abstenim miratohet pika 6 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 7**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj** : Dhe në pikën 7 ku ka disa ndryshime në detajimin e buxhetit të bashkisë së Durrësit për vitin 2024, komisioni është unanimisht dakort dhe e kalon për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit z. Xhelilaj.

Znj. Devolli.

**Edlira Devolli** : Komisioni vendosi që këtë pikë ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit zonja Devolli.

Përsa i përket pikës 7, kemi koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka.

Hapim votimin elektronik.

Ju lutem votoni.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 29 vota pro, 3 abstenim miratohet pika 7 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 8**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj** : Edhe në pikën 8, Komisioni i Buxhetit është unanimisht dakort dhe e kalon për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit z. Xhelilaj.

I japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike Znj. Devolli.

**Edlira Devolli** : Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike u mblodh, e shqyrtoi dhe vendosi që ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit zonja Devolli.

Përsa i përket pikës 8, kemi koment nga ana e këshilltarëve?

**Jonuz Myshketa** : Po dua të ndalem.

**Ani Dyrmishi**: Po z. Myshketa.

**Jonuz Myshketa**: Në raport me pikën 8, qëndrimi jonë është në kohorencë me mbledhjen e kaluar jemi kundër kësaj pike, pasi gjykojmë që procesi i legalizimeve ka pasur mjaftueshëm kohë, dhe bashkia nuk ka pse të rëndohet qoftë në buxhet, qoftë në burime njerëzore për të zgjidhur një proces, i cili është me dekada i pazgjidhur. Ka qenë shumë herë burim abuzimesh, kemi pasur shumë drejtor të këtij institucioni përpara dyerve të prokurorisë etjerë, etjerë dhe janë mbi 15 mijë dosje që nga informacioni që kemi janë të plotësuar. Nuk e di përse do të shërbejë ky aksion? Le të themi në bashkërendim me Bashkinë dhe ASHK-në për të zgjidhur 15 mijë dosje në kohë rekord ku gjatë gjithë kësaj kohe ka qenë e mjaftueshme e gjithë praktika për tu zgjidhur. Jemi të paqartë në lidhje me këtë, prandaj vota jonë është kundër.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit z. Myshketa.

Koment tjetër ?

Atëherë nuk ka. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 31 vota pro, 2 kundra, asnjë abstenim, miratohet dhe pika 8 e rendit të ditës.

- **Pika 9** është hequr nga rendi i ditës.
- Kalojmë **në pikën 10**. I japim fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola.

**Hekuran Markola**: Faleminderit Kryetar.

Atëherë pika 10 kaloi unanimisht nga anëtarët e Partisë Socialiste, sepse opozita mungoj, ku pak më parë dëgjova se kërkonin dhe transparancë përsa i përket pikës 13, duhet të kishin ardhur në komision, aty ishte nënkryetari i bashkisë Genti, që mund jepte më shumë llogari. Kështu që e kalojmë në votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit z. Markola.

Koment përsa i përket pikës 10 kemi?

**Jonuz Myshketa** : Kam unë.

**Ani Dyrmishi**: Po z. Myshketa.

**Jonuz Myshketa**: Në pikën 10 vërehet që pothuajse është dyfishuar numri i vendqëndrimeve ose vendparkimeve për taksitë 4+1 dhe 8+1, janë gati 92 vendpakime të reja. Kjo vjen për shkak se janë rritur licensat? Pra kemi operatorë të rinj në treg apo janë ato operatorë, të cilët kërkojnë automjete të reja? Dhe nga ç'ka vura re, pra kërkesa e lartë për shkak të numrit të njerëzve të cilët

janë shtuar në përdorimin e tyre dhe të turizmit, thuhet në relacion, përbën këtë si nevojshmëri për të përmbushur?

**Hekuran Merkola:** Mund të bëhej në Komision kjo pyetje. Nga ty prisja që të vije.

**Jonuz Myshketa:** Kam pas punë e kam shënuar.

Prandaj jemi në Këshill Bashkiak.

**Emiriana Sako:** Normalisht ne japim në mënyrë të vazhdueshme përsa i përket transportit privat, pra licensim, që do të thotë është detyrimi jonë ligor. Kush vjen pranë bashkisë të aplikojë për një licencë të re në bazë të një liste dokumentacioni, duhet licensuar.

Kërkesa është rritur, është rritur dhe numri i atyre që operojnë dhe normalisht pozicioni i tyre në qytet bëhet me vendim këshilli. Ne kemi vendosur një numër pak më të madh sesa kemi kërkesën në mënyrë që mos ta kthejmë në rutinë që të vijmë në këshill sa herë ka nevojë për një shtesë vendi taksi, por në parim po miratojmë këto vende dhe kush vjen që aplikon mund të ketë, në bazë të rradhës në vëndin përkatës atje ku lejohet. Pra nëqoftëse janë 5 apo 6 pika në qytet subjekti zgjedh se ku do ta stacionojë mjetin e tij.

**Jonuz Myshketa:** Pra janë parashikuar pika se ku mund të zgjedhin subjektet.

**Emiriana Sako:** Po, Po.

**Jonuz Myshketa:** Kisha vetëm një skepticizëm tjetër, duke pasur parasysh sistemin e parkimeve në Durrës, shohim një shtim të numrit të taksive dhe një pakësim të aksesit qytetar për pjesën e parkimit, pra aksesin qytetar për pjesën e parkimit, nga ajo çfarë këkohet a e zgjidh kjo problemin dhe asionon problemin e parkimeve që tatimohen ose taksohen?

**Emiriana Sako:** Por qytetet janë dinamike, normalisht ka një vazhdimësi në punën tonë që rast pas rasti vlerësohet nevoja e vendstacionimit të taksive në qytet dhe kjo është bërë pikërsht për të dhënë shërbime atyre që kërkojnë shërbime pranë bashkisë së Durrësit.

Miratimi përsa i takon parkimeve në qytet, ne bëmë vendimin e këshillit, jemi duke punuar me operatorët e kompanive telefonike celulare në mënyrë që ta automatizojmë si shërbim dhe ta vëmë në jetë sa më shpejtë të jetë e mundur. Dhe mendojmë që kthimi i parkimeve me pagesë në akse kryesore rrugëve të qytetit do ta lehtësojë edhe problematikën, që ju citoni, përsa i takon taksive.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit znj.Kryetare.

Atëherë koment tjetër ka ?

Nuk ka. Kalojmë në votim

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 31 vota pro, 2 abstenim miratohet pika 10 e rendit të ditës.

- Kalojmë në **pikën 11**. I japim fjalën Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike Znj.Devolli.

**Edlira Devolli** : Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike u mbledh, e shqyrtoi dhe vendosi që ta kaloj për votim dhe këtë pikë.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike znj. Musaraj.

**Joniada Musaraj**: Përshëndetje Kryetar ! Përshëndetje të gjithëve !

Komisioni ynë e miratoi me 7 vota, kështu që e propozojmë sot për votim.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit.

Përsa i përket pikës 11 komente kemi?

Atëherë nuk kemi. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

*Atëhere, me 33 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër, miratohet pika 11.*

- Kalojmë në **pikën 12**. I japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale z. Tahiri.

**Florian Tahiri**: Komisioni për Barazinë Gjinore për ndihmën ekonomike u mbledh. Dëgjova që në komisionet e tjera anëtarët e Partisë Demokratike nuk ishin paraqitur, gjej rastin të falenderoj doktoreshën Edlira Shemsi, e cila ishte prezente te komisioni jonë.

Ashtu si dhe pika 1, ndihma ekonomike “PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN TETOR 2024” u miratua në unanimitet nga pjestarët e komisionit.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit z. Tahiri.

Komente përsa i përket pikës 12 ka?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

*Atëhere, me 33 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër, miratohet pika 12 e rendit të ditës.*

- Kalojmë në **pikën 13**. I japim fjalën znj. Devolli, Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike

**Edlira Devolli** : Faleminderit Kryetar.

Komisioni Rregullores, Çështjeve Juridike u mbledh, e shqyrtoi dhe vendosi që ta kaloj këtë mbledhje për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit .

I jap fjalën Komisionit të Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor z. Hekuran Markola.

**Hekuran Markola:** Faleminderit.

Edhe pika 13 në unanimitet kalon për votim në Këshill Bashkiak.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Z. Markola.

Në lidhje me komente ?

Po z. Myshketa.

**Jonuz Myshketa:** E shqyrtova materialin e pikës 13, kam disa paqartësi në lidhje me atë ç'ka thuhet, ku subvencionohet transporti urban qytetas, pa llogaritur dhe transportin ndërqytetas për njësitë administrative përrreth e para, e dyta thuhet se transporti ka pasur humbje për shkak të rritjes së naftës dhe mungesës së pakësimit të numrave të qytetarëve të cilët i përdorin , gjë e cila nuk më duket pak për transportin qytetas kur shoh autobuzet full. Mendoj që subvencionimi i naftës duhet të vijë si për transportin publik ashtu siç mund të jetë dhe për transportin detar ose mjetet e peshkimit, por duhet që problemi i subvencionimit në lidhje me transportin publik qëndron akoma një problem, një problem parësor, pasi shton rradhët, bëhet një katrohurë në rastet kur dalin abonetet e famshme ku ka njerëz që mbajnë rradhën që në 3 të mëngjesit, pra tregon që numri i kërkesave për transport publik nuk është ulur. Bie ndesh edhe me një nga pikat përpara, me pikën 10 që folëm për taksitë ku nga njëra anë parashtrohet që kemi fluks njerëzish, që duan të parkojnë mjetin dhe nga ana tjetër kemi mungesë të mjeteve. Mungesë tjetër është që po do të doja që t'i vijmë në ndihmë transportit urban duke shtuar pikat e stacioneve, sepse shumicat e ndërmarrjeve që operojnë në Durrës ofrojnë transportin ato, sepse nuk i'a përmbush nevojat transporti urban, prandaj duhet të jetë një zgjidhje tjetër përtej subvencionimit mendoj që është e nevojshme. Relacioni mungonte dhe duhen shtuar pikat e tyre qoftë dhe optimizimi i stacioneve të linjave dhe të përfshihet gjithë kjo vëmendje jo vetëm për qytetin, por edhe për rrethinat. Faleminderit.

**Ani Dymishi:** Faleminderit zoti Myshketa.

**Emiriana Sako:** Mirë faleminderit për ndërhyrjen.

Në fakt ne kemi pasur kërkesa të vazhdueshme edhe për takime edhe për përcjellje të shqetësimeve, domethënë edhe kërkesa me shkrim, por edhe kur jemi takuar me subjekte, të cilët operojnë në sektorin e transportit publik. Duam ta diferencojmë se ndryshe nga transporti publik pra bashkia, transporti brenda qytetit është normalisht i ndarë nga ai rrethqytetas, i cili rrethqytetasi i ekuilibron vetë normat e fitimit dhe mbarëvajtjen e procesit të punës nëpërmjet tregut, sepse çmimi i biletës nuk caktohet nga Këshilli Bashkiak, por vetëm për linjat qytetëse normalisht Këshilli Bashkiak është përgjegjëse për nivelin e kategorisë së biletës. Duke mos pasur dëshirë për të bërë rritjen e çmimit të biletës ne kemi parë një alternativë tjetër se si mund t'i subvencionojmë këtë sektor, i cili si argumente për nevojat e subvencionimit ka sjellë uljen e numrit të personave që udhëtojnë me mjete publike, rritjen e inflacionit, rritjen e nivelit të pagave në sektorin e tyre, por dhe rritjen e çmimit të karburantit.

Ka një mbivendosje ose një ndarje të përgjegjësive, sepse mbas ligjit “Për vetqeverisjen vendore” 139 të 2015, kompetenca për menaxhimin e transportit është e bashkisë, por nga ana tjetër është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila nxjerr aktet dhe nënaktet ligjore për mënyrën e subvencionimit. Ka një ligj që lejon që të bëhet subvencionimi, por nuk është detajuar me VKM, mënyra sesi. Ne i kemi referuar dhe bashkive të tjera, të cilat e kanë bërë këtë mbështetje për operatorët, që punojnë në këtë sektor, secila bashki ka parë ato mundësitë dhe nevojat që ka pasur në qytet, Vlora është një shembull, Lushnja është një shembull, Tirana është një shembull që tashmë e kanë bërë këtë, e kanë marrë këtë iniciativë.

Ne sot kemi propozuar në këshill vetëm mënyrën sesi do të bëhet një farë llogaritje, dhe sigurisht vlera e kësaj llogaritje mund të jetë 100 lekë po themi, por ne gjithsesi në vendimin e këshillit të rradhës do të vendosim dhe efektin financiar në bazë dhe të mundësive që ka bashkia, pra ajo sigurisht që nuk do ta mbulojmë dot 100% nevojën. Nga ana tjetër këtyre subjekteve do t'i kërkojmë që të përmirësojnë kushtet e transportit, pra kjo është një element bazë vendosjen e GPS për të matur edhe linjat edhe efektivitetin e tyre dhe me kalimin e kohës do të bëjmë të mundur ta përmirësojmë këtë shërbim, i cili ka nevojë për mbështetje.

Ky vendim do të jetë një vendim, i cili do të qëndroj në fuqi aq kohë sa një VKM do të nxjerrri në mënyrë të detajuar për mënyrën sesi do të bëhet mbështetja për këtë sektor. Ne mendojmë që është një sektor shumë i rëndësishëm i qytetit tonë, duke i dhënë këtë mundësi mbështetje, do të kemi mundësi të kërkojmë për të përmirësuar shërbimin, sepse dihet që jo vetëm gjatë dimrit, por edhe gjatë sezonit turistik ka një ngarkesë të jashtëzakonshme në territor me lëvizshmërinë e njerëzve. Kështu që kjo ishe sa më sipër për shqetësimet që ngritet ju. Kjo nuk ka lidhje me taksitë është një diçka komplet ndryshe, mund të jetë normale që njerëzit preferojnë më tepër të lëvizin me taksi sesa me mjete urbane, por ne këtë iniciativë e kemi filluar në mënyrë që të kemi mundësi që t'i shtrijmë dorën për ndihmë le të themi, këtyre subjekteve dhe të kërkojmë që të rritet përmirësimi i shërbimit në këtë sektor.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit Kryetare.

Koment tjetër?

Nuk ka. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

*Atëhere, me 31 vota pro, 2 abstenim, miratohet pika 13 e rendit të ditës.*

- Kalojmë **në pikën 14**. I japim fjalën Komisionit Rregullorës, Çështjeve Juridike znj.Devolli,

**Edlira Devolli :** Komisioni vendosi që dhe këtë pikë ta kaloj për votim.

**Ani Dyrmishi:** Faleminderit znj. Devolli.

Komente përsa i përket pikës 14, kemi?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Votoni të gjithë.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 33 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet pika 14 e rendit të ditës.

- Kalojmë **në pikën 15**. I japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës dhe Taksave - Tarifave z.Xhelilaj.

**Rolant Xhelilaj** : Miratimi i projektdokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm me rëndësi dhe për faktin .....

E kam shyp?!

**Ani Dyrmishi**: Në rregull e ke.

**Rolant Xhelilaj** : Miratimi i këtij projektdokumenti të parë të programit buxhetor afatmesëm..... Mos qesh Dori, e kemi të vështirë të mësohemi me teknologjinë tashi, punë përvoja.

Me rëndësi sidomos këtë periudhë

Që kemi të bëjmë dhe më miratimin e buxhetit të viti 2025, kalimi i kësaj nga komisioni ishte unanim dhe i shërben punës për realizimin e një harmonizimi shumë të mirë të punës së bashkisë, për hartimin e një buxheti dhe projektbuxheti afatmesëm në përputhje me nevojat e qytetit dhe qytetarëve. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi**: Faleminderit.

Atëherë përse i përket pikës 15, kemi komente nga ana e këshilltarëve?

Komente nuk ka. Kalojmë në votim.

Hapim votimin elektronik.

Atëherë mbyllet votimi me elektronik.

Atëhere, me 31 vota pro, 2 abstenim, miratohet pika 15 e rendit të ditës.

- **Për diskutim**. Ka kërkuar fjalën znj. Devolli.

**Edlira Devolli**: Atëhere përkatësisht për pallate të rindërtuara në lagjen 17 pyetja ime sjell këtu shqetësimin e banorëve është përkatësisht për rrugën, "Buna" dhe rrugën "Ahmet Dakli", të cilat kanë probleme me kanalizimet dhe ndriçimin. Kur do të përfundojnë? Pyetja e parë dhe e dyta është rruga "Pavarësia" aksi i rrugës ura Dajlanit Plepa ka mbi një muaj pa ndriçim, jo që mungojnë shtyllat apo llampat, por qëndrojnë të fikura dhe kjo është rrezik për të krijuar aksidentin. Faleminderit.

**Emiriana Sako**: Janë rindërtuar pallatet atje ku kanë qënë më parë, ne kemi bërë shpërndarjen e apartamenteve, shortet, kemi bërë edhe dorëzimin e çelsave për familjet. Në informacionin që kam unë rezulton që aty firma është ende duke punuar për lidhjen e, pra pikën e lidhjes me ujin e pijshëm dhe furnizimin me energji elektrike. Besoj se do të ketë një afat të shkurtër kohor për mbylljen e këtij procesi, pasi i jemi referuar edhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, pasi është ky institucion ai, që ka lidhur kontratën me firmën fituese, pra bashkia është thjeshtë përfituese e këtij program. Besojmë se brenda muajit do të kenë përfunduar këto dy procese.



E dyta nuk më rezulton që rruga “Pavarësia”, nuk ka ndriçim. “Ne” rast pas rasti bëjmë ndriçimin e llampave që digjen, por për një muaj nuk ka sesi që të qëndrojë vërtetë kjo. Do ta verifikojmë, por nuk më duket, se unë kam kaluar dhe vetë atje, kështu që nuk më duket që të jetë errësirë totale, domethënë siç e pretendoni.

**Ani Dyrmishi:** Atëherë faleminderit Kryetare.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria.

*Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 17 (shtatëmbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

**Mbajtësi i procesverbalit:** Enxhi Gjuzi

**Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :**

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Zëvendëskryetar i Këshillit :

DENISA LUARASI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI

Kryetar i Gr. Partisë Socialdemokrate :

FLUTURA KASA